



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 747/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mehmet Sopjani – ish këshilltar i kuvendit komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Adrian Kelmendit – Plotësues i formularit nga Fushë Kosova, për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Mehmet Sopjanit – ish këshilltar i kuvendit komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK),

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.11.2013, nga Mehmet Sopjani – ish këshilltar i kuvendit komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendohet se, në Sllatin e Madhe në shkollën fillore Bajram Curri në pikën e III-të komisioneri që e ka plotësuar formularin i ka bërë tri përmirësime të numrave në emërin timë. Më tutje ka shtuar se, kandidati me nr. 3 dhe vëzhguesi i KDIS-së dhe i LDK-së kanë nxjerrë shifren më të madhe në krahasim me deklaruesit e tjerë në formular.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrëhet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe

mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrës ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 747/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

The image shows a circular official stamp of the Panel for Complaints and Appeals (PZAP) in Pristina. The stamp contains the text "Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës" and "Prishtinë / Pristina". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.